



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**

**POGRADEC**  
**NR.00110 - 126 REGJ. THEM.**  
**DATA 04.03.2020 REGJISTRIMI**

**NR.(564) -243 VENDIMI**  
**DATA 09.09.2020**

**VENDIM**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Pogradec, e perbere nga:

**GJYQTARE – {xxx}**

asistuar prej sekretares gjyqesore {xxx}, ne Pogradec sot me date 09.09.2020, ora 09:52, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me detyr te mbyllura çeshtjen penale me nr.001 10 - 126 regj. them., qe i perket:

**KERKUESE:** Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec, e perfaqesuar nga drejtuesja e Prokurorise, prokurorja {xxx}.

**PERSON I KALLEZUAR:** {xxx} , i biri {xxx} dhe i {xxx}, i datelindjes {xxx}, lindur dhe banues ne Pogradec, lagjia nr.2, rruga “Rinia”, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, me arsim te mesem, me gjendje civile i martuar me dy femije, i zhvilluar gjykimi pa pjesemartjen e tij.

**OBJEKTI:** Pushimin e çeshtjes penale nr.291, viti 2017 per vepren penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 328/1 shkronja “b”, 329/a, 329/b te K.Pr.Penale.

Gjykata pasi degjoi shpjegimet e prokurores, shqyrtoi provat shkresore, si dhe pasi degjoi **konkluzionet perfundimtare** ku:

**Perfaqesuesja e organit te Prokurorise** kerkoi:

«,

-Pranimin e kerkeses. Pushimin e çeshtjes penale nr.291, viti 2017 per vepren penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**-Personi i kallezuar** {xxx} ishte ne mungese

## VEREN

Se Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec ne daten 02.03.2020 me kerkesen me objekt - Pushimin e çeshtjes penale nr.291, viti 2017 per vepren penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Ne baze te neneve 69, 329/a/l te K.Pr.Penale gjykata konstatoi se kjo çeshtje hyn ne juridiksionin penal, si dhe ne kompetencen lendore dhe tokesore te kesaj gjykate.

### **Rrethanat e çeshtjes:**

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec ka regjistruar procedimin penal nr.291, date 31.08.2017 per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga informacioni i derguar nga Drejtoria per Krimin Ekonomik e Financiar Tirane rezulton se shtetasi {xxx} dhe familjaret e tij kane ne pronesi objekte banimi, disponojne asete dhe llogari bankare ne shuma te konsiderueshme duke kryer edhe transaksione bankare te dyshimta. Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave Tirane me shkresen nr.796/2 Prot, date 20.04.2017 ka derguar informacion per raporte transaksione vlerash, levizje ne llogarite bankare, transaksione financiare per shtetasin {xxx} dhe familjaret e tij.

Sipas informacionit te derguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe rezulton se shtetasi {xxx} eshte regjistruar ne organet tatimore si person fizik me NIPT {xxx}, date regjistrimi 12.12.2011, me objekt "Bar - Restorant" , aplikuar per çregjistrim ne daten 13.01.2015 dhe rezulton se nuk ka te dhena per fitimin e saj, por ka qene i vetepunesuar me keto te dhena per muajin dhjetor 2012, nuk ka te dhena per pagen apo fitimin, per periudhen janar - dhjetor 2013, nuk ka te dhena per pagen apo per fitimin, per periudhen janar - maj 2014, nuk ka te dhena per pagen apo per fitimin, ndersa per periudhen qershor - dhjetor 2014 eshte paguar me nje page mujore qe varion deri ne {xxx} leke, per periudhen janar - shkurt 2015 eshte paguar me nje page mujore bruto {xxx} leke, ndersa per muajt mars-qershor 2015 nuk ka te dhena per pagen apo per fitimin. Po keshtu rezulton se shtetasi {xxx} eshte i regjistruar me NIPT {xxx}, date regjistrimi 04.09.2015 me objekt "Tregetim me pakice mishi dhe prodhimeve te mishit", aktualisht me status aktiv dhe rezulton se nuk ka te dhena per fitimin e saj, por ka qene i vetepunesuar dhe per periudhen shtator - dhjetor 2015 eshte paguar me nje page mujore prej {xxx} leke, per periudhen janar - dhjetor 2016 eshte paguar me nje page mujore bruto prej {xxx} leke, per perudhen janar - prill 2017 eshte paguar me nje page mujore bruto {xxx} leke. Rezulton i regjistruar ne organet tatimore ne emer te tij dhe biznesi "Tregetim me pakice mishi" me NIPT K33715733S, regjistruar ne vitin 2001, por qe nga viti 2011 eshte me status pasiv dhe nuk ka te dhena per aktivitetin e kesaj shoqerie. Shtetasja {xxx} (bashkeshortja e shtetasit {xxx} ) eshte e regjistruar si person fizik me NIPT K33715733S ne date 01.01.2001 me objekt "Floktore dhe institute te tjera bukurie" dhe kaluar ne regjistrim pasiv ne daten 05.05.2011.

Sipas informacionit te vene ne dispozicion nga Zyrat e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton se shtetasi {xxx} nuk ka te regjistruar ndonje pasuri te paluajtshme ne emer te tij, bashkeshortes apo femijeve te tij.

Nga informacioni i derguar nga A.L.U.I.Z.N.I Korçe rezulton se shtetasja {xxx} (e ema e shtetasit {xxx}) është aplikuese për legalizimin e objektit “Rikonstruksion lokali shërbimi + ngritje kati me çati të shfrytëzuar” në Udenisht Pogradec.

Nga informacioni i derguar nga Bashkia Pogradec rezulton se në baze të VKM-se nr.934, datë 29.12.2014 është vendosur shpronësimi i shtetasës {xxx} në vlerën {xxx} leke për objektin “Lokal shërbimi hotel 3 kate” në Udenisht Pogradec.

Nga informacioni i përcjelle nga D.R.SH.T.RR Korçe rezulton se shtetasi {xxx} ka patur në pronësi automjetet me targë {xxx} dhe {xxx}, por aktualisht nuk ka asnjë automjet në pronësi dhe as familjaret e tij.

Nga analiza e informacionit të përcjelle nga Bankat e nivelit të dytë të cilat operojnë në vendin tone rezultojnë këto transaksione ndër vite;

-në emër të shtetasit {xxx} janë derdhur në Raiffeisen Bank nga shtetasja {xxx} shuma {xxx} leke në datë 09.02.2015 dhe shuma {xxx} leke në datë 17.02.2015; në datën 25.02.2015 është derdhur shuma {xxx} leke me përshkrimin “të ardhura nga biznesi dhe kompesim i pronës”; në datën 02.03.2015 është derdhur shuma {xxx} leke me përshkrimin “rivlerësim pasurie”; në datën 03.03.2015 është derdhur shuma 1.400.000 leke me përshkrimin “rivlerësim objekt biznesi hotel”; në datën 16.04.2015 shtetasi {xxx} ka dërguar në llogarinë e bashkeshortës së tij {xxx} shumën {xxx} leke dhe deri në datën 28.10.2016 në këtë llogari ka mbetur gjendje në depozitë shuma {xxx} leke.

-shtetasi {xxx} dhe familjaret e tij ({xxx} -bashkeshortja dhe {xxx} - e ema) kanë marrë kredi në Alpha Bank më janar 2008 në shumën {xxx} leke, e cila është mbyllur në datën 28.02.2015. Nga kjo shumë, {xxx} leke janë tërhequr në datën 16.01.2008 dhe përdorur për shlyerjen e kredive pranë Bankës Popullore; {xxx} leke janë tërhequr në datën 17.01.2008 dhe përdorur si pagesë për kestin e blerjes së apartamentit; {xxx} leke janë tërhequr në datën 17.01.2008 dhe përdorur si pagesë për kestin e blerjes së apartamentit; Po kështu në Alpha Bank rezulton të ketë patur llogari bankare, ku janë kryer disa depozitime në datën 13.08.2012 shuma monetare {xxx} leke konvertim nga llogaria në euro e shtetasës {xxx}; në datën 29.10.2014 shuma monetare {xxx} derdhur nga shtetasi {xxx} me përshkrimin “kursime të familjes nga emigracioni; në datën 12.11.2014 shuma {xxx} leke me përshkrimin “të ardhura nga kontrata e shitjes”. Po kështu shtetasja {xxx} ka patur llogari në këto banka, ku në datën 20.01.2015 janë derdhur {xxx} leke me përshkrimin “VKM nr.909, dt.29.12.2014...”, shumë e cila është tërhequr pjesë-pjesë nga {xxx} dhe transferuar në llogarinë e Albanit në Raiffeisen Bank.

-në datën 22.08.2012 në ProCredit Bank është kredituar në emër të shtetasës {xxx} shuma {xxx} leke dhe {xxx} nga shtetasi {xxx} me përshkrimin “të ardhura nga shitja/blerja e pronës dyqan), e cila është tërhequr pjesë-pjesë nga {xxx} dhe {xxx} deri në datën 25.12.2012, datë në të cilën kjo depozitë është 0 leke. Në një tjetër llogari në kursin USD në emër të shtetasës {xxx} në datën 20.11.2012 është depozituar shuma {xxx} USD, me përshkrimin “të ardhura nga shitja e pronës”, të cilat në datën 23.11.2012 janë transferuar në llogarinë e shtetasës {xxx} në SHBA me përshkrimin “transfer të për blerje shtëpie në Amerikë Bank of America...”.

-në bankën Societe Generale Albania shtetasët {xxx} dhe {xxx} rezultojnë të jenë kredimarrës, konkretisht shtetasja {xxx} ka përfituar dy kredi me keste-standart hapur në datë 04.09.2006 në vlerën {xxx} leke dhe tjetra hapur në datën 03.11.2006 në vlerën {xxx} leke, ndërsa shtetasja {xxx} ka përfituar dy kredi kolateral-meme-hip.mbi truall +ndertese hapur në datën 06.07.2006 në shumën {xxx} leke dhe tjetra hapur në datën 01.12.2006 në shumën {xxx} leke.

1 pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi {xxx} ka deklaruar se prej vitit 1995 babai i tij që nuk jeton më ka nisur të ndërtojë në fshatin Udenisht një objekt “Bar-restorant-hoteleri” që ka

perfunduar ne vitin 2007 dhe deri ne vitin 2015 kane punuar atje familjarisht. Ne vitin 2015 ky objekt eshte prishur nga INUK dhe ata jane demshperblyer nga shteti ne shumen afer {xxx} leke. Shuma e shpronësimit ka kaluar fillimisht ne nje llogari te nenes se tij dhe me pas kur ka kaluar ne llogarine e tij, ai e ka kaluar ne llogarine e bashkeshortes se tij {xxx} qe jeton prej vitit 2008 ne Amerike se bashku me femijet. Po keshtu bashkeshortja e tij {xxx} ka shitur me autorizimin e nenes se saj nje dyqan qe ka qene ne pronesi te te emes se saj dhe te ardhurat e siguruar nga kjo shitje jane derdhur ne llogarine e {xxx} ne Amerike pasi atje i kane investuar te gjitha te ardhurat e tyre te siguruara nga shpronësimi dhe shitblerjet e pasurive, pasi kane patur si qellim te blejne shtepi ne Amerike. Ai deklaroi se ne vitin 2004 eshte proceduar penalisht por me vendim te Gjykates se Apelit per Krimet e Renda, lene ne fuqi dhe nga Gjykata e Larte eshte deklaruar i pafajshem.

Nga organi procedues eshte administruar vendimi gjyqsor nr.51, date 27.12.2010 i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane nepermjet te cilit shtetasi {xxx} eshte deklaruar per fajtor per veprat penale "Trafikim i narkotikeve" dhe "Falsifikim i leternjoftimeve apo vizave" dhe ne baze te neneve 283/a/2 e 189/1 te Kodit Penal eshte denuar me 13 vjet burgim dhe 400.000 leke gjobe. Ky vendim eshte ndryshuar nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane me vendimin nr.22, date 05.04.2011 duke vendosur prishjen e vendimit nr.51, date 27.12.2010 dhe pushimin e çeshtjes ne ngarkim te te pandehurit {xxx} per kryerjen e vepres penale "Trafikim i narkotikeve", parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, pasi nuk vertetohet fajesia e te pandehurit per kete veper penale. Vendimi i Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Larte Tirane me vendimin nr.00-2014-1977 (160), date 02.07.2014.

**Faktet e mesiperme rezultuan nga aktet e hetimeve paraprake te mbledhura nga organi i Prokurorise te cilat ju nenshtroan shqyrtimit gjyqsor, konkretisht:**

Shkresa kthim pergjigje nr.2849/1 prot, date 21.06.2017 e Zyres Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Pogradec.

Shkresa dergim informacioni nr.3188/1 prot, date 19.06.2017, e Drejtorise se ALUIZNI-t Korçe bashkengjitur aktet.

Shkresa kerkim informacioni nr. 1444 prot, date 09.06.2017 e Drejtorise Vendore te Policise Korçe.

Shkresa dergim informacioni nr.2063/1 prot, date 29.06.2017 e Komisarariatit te Poiicise Pogradec.

Shkresa kthim pergjigje nr.9235/1 prot, date 20.06.2017, e Drejtorise se Sherbimit per Tatimpaguesit bashkengjitur aktet.

Shkresa kerkim informacioni nr.1446 prot, date 09.06.2017 e Drejtorise Vendore te Policise Korçe.

Shkresa kthim pergjigje nr.3010/1 prot, date 15.06.2017, e Drejtorise Rajonale te Sherbimeve te Transportit Rrugor Korçe bashkengjitur aktet.

Shkresa kerkim informacioni nr.1447 prot, date 09.06.2017 e Drejtorise Vendore te Policise Korçe.

Shkresa kthim pergjigje nr. 14265/2 prot, date 25.06.2017 e Drejtorise se Hetimit te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave.

Shkresa kerkim informacioni nr.1448 prot, date 09.06.2017 e Drejtorise Vendore te Policise Korçe.

Shkresa kerkim informacioni nr.1449 prot, date 09.06.2017 e Drejtorise Vendore te Policise Korçe.

Shkresa kerkim informacioni nr.4845 prot, date 04.10.2017 e organit te Prokurorise drejtuar bankave qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne Shqiperi.

Shkresa kthim pergjigje nr.37403/1 prot, date 11.10.2017, e Raiffeisen Bank bashkengjitur aktet.

Shkresa nr.17/16276/tbo-002 prot, bashkengjitur aktet nga Societe Generale Albania. Shkresa kthim pergjigje nr.7308 prot, date 10.10.2017, bashkengjitur aktet nga ProCredit Bank.

Shkresa kthim pergjigje nr.31544 prot, date 10.10.2017, bashkengjitur aktet nga Alpha Bank.

Shkresa kthim pergjigje nr.29059/17 ref, date 12.10.2017, nga UBA Banka e Bashkuar e Shqiperise.

Shkresa kthim pergjigje nr. 17/49957 prot, date 11.10.2017, nga Intesa SanPaolo Bank. Shkresa

kthim pergjigje date 10.10.2017, bashkengjitur aktet nga Banka NBG Albania. Shkresa kthim

pergjigje nr.49849/1 prot, date 11.10.2017, nga Credins Bank.

Shkresa kthim pergjigje nr.9342 prot, date 11.10.2017, nga Intemational Commercial Bank.  
Shkresa kthim pergjigje nr.37305/1 prot, date 09.10.2017, nga Veneto Bank.  
Shkresa kthim pergjigje nr. 19122 prot, date 11.10.2017, nga Tirana Bank.  
Shkresa kthim pergjigje nr.10810 prot, date 11.10.2017, nga Amerikan Bank 'of Investments.  
Shkresa kthim pergjigje nr. 13093/2017 prot, date 10.10.2017, nga CBA Banka e Creditit te Shqiperise.  
Shkresa kthim pergjigje nr.ON-A-35956/2017 prot, date 20.10.2017, nga Fibank.  
Shkresa kthim pergjigje nr.4133/1 prot, date 27.10.2017, ngaZVRPP Tepelene.

- Shkresa kthim pergjigje nr.6078/1 prot, date 31.10.2017, nga ZVRPP Gjirokaster.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.3306/1 prot, date 01.11.2017, nga ZVRPP Elbasan.
- Shkresa kthim pergjigje nr.37745/1 prot, date 31.10.2017, nga ZVRPP Tirane.
- Shkresa kthim pergjigje nr.8761/1 prot, date 01.11.2017, nga ZVRPP Fier.
- Shkresa kthim pergjigje nr.9542/1 prot, date 30.10.2017, nga ZVRPP Vlore.
- ® Shkresa nr.6794/1 prot, date 18.10.2017, e ZQRPP Tirane.
- Shkresa kthim pergjigje nr.4171/1 prot, date 27.10.2017, nga ZVRPP Gramsh.
- Shkresa kthim pergjigje nr.4046/1 prot, date 02.11.2017, nga ZVRPP Kuçove.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.6688/1 prot, date 28.10.2017, nga ZVRPP Pogradec.
- Shkresa kthim pergjigje nr.4730/1 prot, date 25.10.2017, nga ZVRPP Librazhd.
- » Shkresa kthim pergjigje nr. 1673/1 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Devoll.
- Shkresa kthim pergjigje nr.4371/1 prot, date 23.10.2017, nga ZVRPP Diber.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.7218/1 prot, date 27.10.2017, nga ZVRPP Kavaje.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.4398/1 prot, date 23.10.2017, nga ZVRPP Kukes.
- Shkresa kthim pergjigje nr.4469/1 prot, date 23.10.2017, nga ZVRPP Skrapar.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.8653 prot, date 23.10.2017, nga ZVRPP Malesi e Madhe.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.8182/1 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Kurbin.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.12217/1 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Durres.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.6234 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Tropoje.
- Shkresa kthim pergjigje nr.7184/1 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Berat.
- Shkresa kthim pergjigje nr.4450 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Has.
- Shkresa kthim pergjigje nr.7789/1 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Korçe.
- Shkresa kthim pergjigje nr. 14926/1 prot, date 24.10.2017, nga ZVRPP Sarande.
- Shkresa kerkim informacioni nr.4844 prot, date 04.10.2017 e organit te Prokurorise.
- » Shkresakthim pergjigje nr.5231/1 prot, date 09.10.2017, nga DRSHTRR Korçe.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.14241/1 prot, date 12.10.2017, nga Sektori i Regjistrimit te Biznesit.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.15239/1 prot, date 16.10.2017, nga Sektori i Asistences dhe Sherbimit per Tatimpaguesit.
- Shkresa kerkim informacioni nr.4843 prot, date 04.10.2017 e organit te Prokurorise.
- Shkresa kthim pergjigje nr.3569/1 prot, date 09.11.2017, nga Bashkia Pogradec bashkengjitur aktet.
- » Shkresa kerkim informacioni nr.4846 prot, date 04.10.2017 e organit te Prokurorise drejtuar Drejtorise Rajonale per Kufirin dhe Migracionin.
- ® Shkresa kthim pergjigje nr.3434/1 prot, date 10.10.2017, nga Drejtoria Vendore per Kufirin dhe Migracionin bashkengjitur aktet.
- Shkresa kerkim informacioni nr.4850 prot, date 04.10.2017 e organit te Prokurorise drejtuar Zyres Qendrore Kombetare Interpol Tirana.
- » Shkresa kthim pergjigje nr.9306 prot, date 13.10.2017, nga Zyra Qendrore Kombetare Interpol Tirana.
- Shkresa kerkim informacioni nr.5425 prot, date 31.10.2017 e organit te Prokurorise drejtuar Gjykates se Krimeve te Renda Tirane.
- » Shkresa kerkim informacioni nr.4849 prot, date 04.10.2017 e organit te Prokurorise drejtuar Prokurorise se Krimeve te Renda.
- Shkresa kthim pergjigje nr.9625/1 prot, date 06.11.2017, e Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, bashkengjitur aktet.
- Shkresa kthim pergjigje nr.1318/1 prot, date 02.11.2017 e Gjykates se Shkalies se Pare per Krimet

- e Renda Tirane, bashkengjitur aktet.
- Shkresa kerkim te dhenash nr.4848 prot, date 04.10.2017 drejtuar Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve Zyres se Gjendjes Gjyqesore.
- Vertetim i gjendjes gjyqesore nr. 17 prot, date 27.10.2017.
- Shkresa kthim pergjigje nr.871/1 prot, date 11.10.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Pogradec.
- Shkresa kthim pergjigje nr.889/1 prot, date 13.10.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Pogradec.
- Çertifikate personale date 22.06.2017, date 05.06.2017, date 30.05.2017, per {xxx} .
- Çertifikate personale date 22.06.2017 {xxx} , date 22.06.2017 Klei hamzallari, date 22.06.2017 Rajan Hamzallari, date 05.06.2017, date 22.06.2017 {xxx} .
- Çertifikate personale date 22.06.2017 Theodhoraq Janaqi, date 22.06.2017 Zhuljeta Janaqi.
- Çertifikate familjare date 22.06.2017, date 05.06.2017, date 30.05.2017 per {xxx} , date 22.06.2017, date 05.06.2017 per {xxx} , date 22.06.2017, date 05.06.2017 per Theodhoraq Janaqi dhe date 01.06.2017 per Bashkim Hamzallari.
- » Te dhena nga sistemi TIMS.
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per vepren penale shtetasi {xxx} , date 02.11.2017.
- Akt kontrolli date 01.06.2018, date 01.12.2018.
- Procesverbal mbi shpenzimet procedurale date 30.01.2020.

**Perfaqesuesja e organit te Prokurorise theksoi nder te tjera si vijon:**

Vepra penale e pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale presupozon pastrimin e produkteve qe jane rrjedhoje e kryerjes se nje vepre penale.

Ne rastin objekt hetimi indicjet (transaksionet bankare) nuk arrijne te kalojne pragun e dyshimeve te arsyeshme dhe ne keto kushte, ne mungese te nje vepre penale baze qe sherben per konfigurimin e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, nuk kemi te bejme me nje veper penale te tille.

Lidhur me vepren penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, vepra penale baze nga e cila gjenerojne produktet perbehet vetem nga ato vepra qe prodhojne nje pasurim te dukshem e te prekshem dhe qe hyn ne disponibilitetin e subjektit. Per te pasur vepren penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, veprimet kriminale e pershkruara nga norma penale kane per synim te perbashket pengimin e identifikimit te prejardhjes se sendeve te dyshuara si produkte te veprimtarise kriminale dhe ndalimin e futjes se tyre ne qarkullimin civil apo mbulimin e prejardhjes. Ne keto kushte, dyshimi per kryerjen e kesaj vepre penale, nuk mund te mbeshtetet vetem ne posedimin e sendeve apo kryerjen e transaksioneve me vlere te larte, pasi kerkohet nje nivel me i larte indicjesh qe duhet te lidhe shumat e perdorura ne aktivitete ne veprimjari sipermarrese me dyshimin per prejardhjen dhe veprimin e kunderligjshem, nga te cilat jane krijuar keto shuma.

Ndodhur ne kushtet, kur nuk plotesohen te treja kushtet kumulative te parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal organi i akuzes çmon se nuk mund te vijoje me hetimin e metejshem te kesaj çeshjee penale persa kohe qe fakti i ndodhur nuk perben vepre penale.

Bazuar ne aktet dhe provat e administruara ne kuader te ketij procedimi penal vleresohet se ne rastin konkret nuk jane konsumuar elementet e figures se vepres penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Per rrjedhoje hetimet ne kuader te ketij procedimi penal nuk mund te vazhdojne, sepse fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si veper penale.

### **Vleresimi i gjykates:**

Duke analizuar rrethanat e çeshtjes, duke shqyrtuar aktet qe i perkasin procedimit penal nr.291, date 31.08.2017, gjykata ne lidhje me kerkesen e organit te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec per pushimin e çeshtjes penale per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal konstaton si me poshte:

**Se pari:** Organi i Prokurorise ne perputhje me nenin 329/a pika 1 te K.Pr.Penale i shtuar ky nen me ligjin nr.35/2017 ka paraqitur para gjyqtarit te seances paraprake kerkesen per pushimin e çeshtjes penale, pasi ka perfunduar hetimet paraprake ne lidhje me procedimin penal nr.291, date 31.08.2017, per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, veper e cila cilesohet nga ligji si krim dhe ka konstatuar se ekziston rasti i parashikuar nga neni 328 paragrafi i pare, shkronja "b" e K.Pr.Penale per pushimin e çeshtjes.

Konform nenit 329/a, pika 3 te K.Pr.Penale kerkeses se organit te akuzes per pushimin e çeshtjes penale i jane bashkelidhur aktet e fashikullit te hetimeve paraprake.

**Se dyti:** Ne situaten konkrete jane kushtet ligjore te parashikuara nga neni 328 pika 1, shkronja "b" te K.Pr.Penale, i ndryshuar ky nen me ligjin nr.35/2017 per pushimin e çeshtjes, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.

Nga aktet e procedimit penal rezulton se organi i akuzes ka regjistruar procedimin penal dhe ka kryer hetime per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**Neni 287 i Kodit Penal** parashikon shprehimisht se: *"Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale, nepermjet:*

*a) kembimit ose transferimit te pasurise, me qellim fshehjen ose mbulimin e origjines se paligjshme te saj, duke ditur se kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; b) fshehjes ose mbulimit te natyres se vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronesise ose te drejtave ne lidhje me pasurine, duke ditur qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale;*

*c) ciftimit te pronesise, posedimit ose perdorimit te pasurise, duke e ditur ne çastin e mcirrjes ne dorezim te saj, qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; ç) kryerjes se veprimeve financiare ose transakcioneve te copezuara per shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit per parandalimin e pastrimit te parave;*

*d) investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave a sendeve, duke ditur se jane produkte te vepres penale ose veprimtarise kriminale;*

*dh) keshillimit, ndihmes, nxitjes ose thirrjes publike per kryerjen e seciles prej veprave te percaktuara me siper;*

*- denohet me burgim nga pese gjer ne dhjete vjet.*

*Kur kjo veper kryhet gjate ushtrimit te nje veprimtarie profesionale, ne bashkepunim ose me shume se nje here, denohet me burgim nga shtate gjer ne pesembedhjete vjet.*

*E njejta veper, kur ka sjelle pasoja te renda, denohet jo me pak se pesembedhjete vjet me burgim .*

*Dispozitat e ketij neni zbatohen edhe kur:*

*ajvepra penale, produktet e se ciles pastrohen, eshte kryer nga nje person qe nuk mund te merret si i pandehur ose qe nuk mund te denohet;*



*b) ndjekja penale per vepren, produktet e se ciles pastrohen, eshte parashkruar ose amnistuar; c) personi qe kryen pastrimin e produkteve eshte i njejte me personin qe ka kryer vepren, nga e cila kane rrjedhur produktet;*

*ç) per vepren penale, nga e cila kane ardhur produktet, nuk eshte filluar asnjehere çeshtja penale apo nuk eshte dhene nje denim me vendim penal te formes se prere;*

*d) vepra penale, produktet e se ciles pastrohen, eshte kryer nga nje person, pavaresisht shtetesise se tij, jashte territorit te Republikes se Shqiperise dhe eshte njekohesisht e denueshme, si ne shtetin e huaj, ashtu edhe ne Republiken e Shqiperise.*

*Dijenja dhe qeliimi, sipas paragrafit te pare te ketij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive ”.*

**Objekt** i vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”. te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal jane marrëdhëniet juridike te vendosura per te siguruar funksionimin e rregullt te organeve te administrates publike dhe mbrojtjen e interesit te shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve te vepres penale. Ndersa objekt material perben vete produkti i vepres penale qe “pastrohet”.

**Nga ana objektive** vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal kryhet me veprime te kunderligjshme, ne menyra te ndryshme si nepermjet; kembimit ose transferimit te pasurise qe dihet se eshte produkt i vepres penale ose veprimtarise kriminale ; fshehjes ose mbuiimit te natyres se vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit vendosjes, zhvendosjes se pronesise ose te drejtave qe lidhen me pasurine qe eshte produkt i vepres penale ose veprimtarise kriminale; fitimit te pronesise, posedimit ose perdorimit te pasurise duke e ditur qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose veprimtarise kriminale; kryerjes se veprimeve financiare dhe transaksioneve te copezuara per shmangien nga raportimi sipas ligjit per parandalimin e pastrimit te parave; investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave ose sendeve qe dihet se jane produkt i vepres penale ose veprimtarise kriminale.

Per te pasur vepren penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal midis veprimeve te autorit te vepres penale (*qe synon pastrimin e produktit te vepres penale*) dhe pasojes apo mundesise se ardhjes se saj (*pastrimi i produktit te vepres penale*) duhet te ekzistojë lidhja shkakesore e drejtperdrejte dhe e domosdoshme, kjo pasi pastrimi i produktit te vepres penale (pasoja) duhet te vije ekskluzivisht dhe drejtperdrejte nga veprimet e autorit te vepres penale (shkaku).

Gjykata vlereson ashtu si dhe organi i Prokurorise se qe nje person te mbaje pergjegjesi penale per kryerjen e vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale“ e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal duhet qe te plotesohen disa kushte ne menyre kumulative: 1) te kete dyshime pertej nivelit te dyshimit te arsyeshem, prova bindese se vete ky person, familjaret apo te afermit e tij (*nuk perjashtohen personat e njohur prej tij si shoke, miq, kolege, ortake etj*) kryejne veprimtari te jashtligjshme si psh; trafik lendesh narkotike, akte korruptive, trafik njerezish etj nga te cilat perfitohen te ardhura;

2) personi te disponoje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme qe nuk justifikohen nga te ardhurat e tij, te cilat jane perfituar duke kryer nje pune apo veprimtari te ligjshme, pra personi nuk justifikon pasurine qe posedon, pasi ajo nuk perputhet me ato qe ai fiton ne menyre te ligjshme. Sipas teorise se te drejtes penale per te pasur ekzistencen e elementeve te vepres se “Pastrimit te produkteve te vepres penale” duhet medoemos qe pasuria e krijuar apo vlera monetare qe ka sherbyer per krijimin e kesaj pasurie te jete rrjedhoje e perfitimeve te ardhura nga aktiviteti kriminal i kryer (shih vendimin nr. 327 ,date 05.12. 2012 te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte;

3) te ardhurat e perfituara nga kryerja e veprimtarive te paligjshme te jene perdorur apo perdoren per veprimtari te ligjshme me qellim fshehjen e origjines se tyre.

Lidhur me kuptimin e produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale te parashikuara ne nenin 287 te Kodit Penal, te cilat i nenshtrohen pastrimit gjykata ne te njejten linje, si dhe organi i akuzes i

referohet nenin 36 te Kodit Penal, i cili sanksionon ne piken 1 germa “b” se : “Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit: b)te produkteve te vepres penale, ku perfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore qe vertetojne tituj ose interesa te tjere ne pasurine qe rrjedh ose fitohet drejtperdrejt ose terthorazi nga kryerja e vepres penale

Kuptimi i produktit te vepres penale eshte sanksionuar dhe ne aktin nderkombetar Konventen e Keshillit te Europes “Per pastrimin, kerkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve te krimit dhe per financimin e terrorizmit” e ratifikuar nga Republika e Shqiperise me ligjin nr.9646, date 27.11. 2006. Ne nenin 1 germa “a” dhe “b” te Konventes parashikohet se :

a) ”produkt” nenkupton çdo avantazh ekonomik te nxjerre nga veprat penale. Ky avantazh mund te konsistoje ne çdo pasuri, siç percaktohet ne nenparagrafin b te ketij neni

b) “pasuri ” nenkupton pasuri te çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet qe vertetojne nje titull ose interes mbi kete pasuri”.

**iNe situaten konkrete nga teresia e akteve te fashikullit te hetimeve paraprake te cilat jane te plota gjykata konstaton se eshte plotesisht i drejte perfundimi i organit te Prokurorise qe nga shtetasi {xxx} apo nga anetaret e familjes se tij nuk jane konsumuar elementet e figures se vepres penale te ‘Tastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale’ e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ne kete konkludim gjykata ka parasysh rrethanat e meposhtme te provuara nga aktet e mbledhura gjate fazes se hetimeve paraprake, te arsyetura nga organi i akuzes:**

-Shtetasi {xxx} dhe bashkeshortja e tij {xxx} jane marre nga viti 2001 e ne vazhdim me aktivitete private ku rezultojne te regjistruar si persona fizike me objekt te veprimtarise “Bar-restorant”, “Tregtim me pakice mishi ose produkte mishi”, “Floktore apo institute bukurie”.

-Shtetasi {xxx} apo bashkeshortja e tij nuk kane te regjistruar pasuri te paluajtshme apo automjete ne emerte tyre.

Ne emer te nenes se shtetasit {xxx} , shtetases {xxx} ka qene e regjistruar prej vitit 2001 pasuria e paluajtshme nr. 185/5 dhe 185/6 me siperfaqe 1300 m2 are dhe 288 m2 ndertese (objekt bar-restorant-hotel ne Udenisht) perte cijen ne vitin 2007 eshte dhene leje ndertimi per rikonstruksion lokal sherbimi dhe ngritje kati me çati te shfrytezuar dhe ne vitin 2014 eshte aplikuar per legalizimin e shtesave te kryera ne kete objekt. Ne vitin 2015 ne baze te VKM-se nr.934 date 29.12.2014 eshte vendosur shpronnesimi i shtetases {xxx} ne vleren {xxx} leke per objektin “Iokal sherbimi hotel 3 kate” ne Udenisht Pogradec.

-Shtetasi {xxx} apo familjaret e tij nuk rezultojne te kene aktualisht gjendje ne llogarite bankare ne bankat e nivelit te dyte qe operojne ne shtetin shqiptar apo gjendjet aktuale jane ne shuma relativisht te paperfillshme, por rezulton te kene kryer transferta / Ievizje depozitim/terheqje te shumave te konsiderueshme monetare te cilat justifikohen si me periudhat kohore kur jane kryer dhe me burimet e ligjshme nga te cilat e kane patur prejardhjen. Ketu kihet parasysh qe ne llogarine e nenes se shtetasit {xxx} , shtetases {xxx} eshte kaluar shuma e shpronnesimit te objektit te prishur, ne daten 20.01.2015 jane derdhur {xxx} leke, te cilat me pas kane kaluar pjese-pjese ne Uogarine bankare te shtetasit {xxx} dhe me pas nje pjese eshte transferuar ne llogarine bankare te bashkeshortes se tij {xxx} ne SHBA ku jeton prej vitit 2008 me femijet. Gjithashtu levizjet e kryera ne llogarite bankare te bashkeshortes se shtetasit {xxx} , shtetases {xxx} justifikohen ne periudha kohore dhe ne burimet e ligjshme te origjines, pasi ne daten 22.08.2012 ne ProCredit Bank eshte kredituar ne emer te saj shuma {xxx} leke dhe 1.860.000, si te ardhura qe rrjedhin nga shitja e prones- dyqan ne emer te nenes se saj, e cila me pas eshte terhequr pjese-pjese nga {xxx} e Aiban Hamzallari dhe ne daten 20.11.2012 eshte depozituar shuma {xxx} USD qe jane “te ardhurat nga shitja e prones-dyqan”, te cilat tre dite me vone, ne daten 23.11.2012 jane transferuar ne llogarine e shtetases {xxx}

ne SHBA me pershkrimin “transferte per blerje shtepie ne Amerike”.

-Shtetasi {xxx} rezulton te jete denuar me vendimin nr.51, datre 27.12.2010 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, te ndryshuar me vendimin nr.22, date 05.04. 2011 te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane vetem per vepren penale “Falsifikim i leternjoftimeve apo vizave”, parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, nderkohe qe per vepren penale te “Trafikimit te narkotikeve“, ne bashkepunim e mbetur ne tentative, e parashikuar nga nenet 283/a/2 e 22 te Kodit Penal Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane me vendimin nr.22, date 05.04.2011 te lene ne fuqi nga Gjykata e Larte ka vendosur pushimin e ceshtjes ne ngarkim te te pandehurit {xxx} , pasi nuk vertetohet fajesia.

Vepra penale e “Falsifikimit te leternjoftimeve apo vizave”, e parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, e kryer nepermjet falsifikimit te nje pasaporte, per te cilen eshte denuar shtetasi {xxx} nuk mund te konsiderohet si e nje natyre te tille nga e cila perfitohen te ardhura te paligjshme.

Lidhur me familjaret e shtetasit {xxx} konstatohet se nuk rezultojne persona te denuar, te proceduar penalisht apo te dyshuar si persona te perfshire ne veprimtari apo aktivitete te paligjshme dhe kriminale.

-Nga informacioni i vene ne dispozicion te organit procedures nga bankat e nivelit te dyte, te cilat operojne ne shtetin shqiptar, shtetasi {xxx} apo familjare tij nuk rezultojne te kene kryer transaksione te dyshimta me vlera te konsiderueshme te bera nga persona te panjohur apo te dyshimta nga jashte apo brenda vendit. Nga keta shtetas jane qarkulluar shuma monetare relativisht te larta, burimi i te cilave jane te ardhurat nga aktivitetet e tyre private nga viti 2001 e ne vazhdim, te ardhura nga shitblerja e pasurise te paluajtshme (dyqan), te ardhurat nga emigracioni duke qene se bashkeshortja e tij shtetasja {xxx} prej vitit 2008 jeton ne SH.B.A, apo te ardhurat e perfituara nga shperblimi per prishjen e prones se paluajtshme ne emer te nenes se shtetasit {xxx} shtetases {xxx} .

Nga shtetasi {xxx} apo anetaret e familjes se tij nuk konstatohen transaksione te dyshimta me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme me qellim fshehjen e origjines se tyre si p.sh. transferimi tek personat e trete nepermjet shitjes apo dhurimit. Veprimet e shitblerjes se pasurive te paluajtshme apo levizjet ne llogarite bankare te kryera nder vite nga keta shtetas jane formalizuar ne akte noteriale dhe jane kryer nepermjet bankave. Po keshtu shumate monetare te perfituara nga shitblerja e pasurise se nenes se shtetases {xxx} dhe ato te perfituara nga kompesimi i prishjes se objektit te nenes se shtetasit {xxx} jane perdorur per tu investuar per blerje banese ne SHBA ku jeton prej vitit 2008 shtetasja {xxx} me femijet.

-Vetem fakti se shtetasi {xxx} apo familjaret e tij kane patur ne pronesi te tyre pasuri te luajtshme apo te paluajtshme me vlere te konsiderueshme nuk eshte i mjaftueshem per te arritur ne perfundimin se keta persona kane konsumuar elementet e figures se vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale“ parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, perderisa ata kane kryer aktivitete te ligjshme tregtare, apo nga perfitimi i shumave te konsiderueshme te kompensimit te prishjes se objektit ne pronesi te shtetases {xxx} (nena e shtetasit {xxx} ) dhe shitja e pasurive te paluajtshme jane siguruar shuma te konsiderueshme parash dhe per aq kohe sa nuk ka as prova apo indicje se ata jane te perfshire ne aktivitete apo veprimtari kriminale, nga e cila jane perfituar te ardhura te paligjshme dhe nuk kane kryer transaksione apo veprime te tjera me pasuri te perfituara ne menyre te paligjshme me qellim fshehjen e burimit apo origjines se tyre.

-Fakti se shtetasi {xxx} eshte arrestuar dhe proceduar penalisht per aktivitetin e paligjshem te “Trafikimit te narkotikeve”, per te cilin i eshte pushuar akuza me vendim gjyqsor te formes se prere nuk mund te konsiderohet si prove apo indicje se ai ka konsumuar elementet e figures se vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale“ parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

-Pasuria e paluajtshme qe kane patur dhe poseduar familjaret e shtetasit {xxx} , objekti “Bar-restorant-hotel” ne Udenisht eshte krijuar ne vazhdimesi nga viti 1995-2001 deri kur eshte regjistruar ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Pogradec dhe gjate kesaj periudhe kohore shtetasi {xxx} apo familjaret e tij nuk rezutojne te jene marre me aktivitet te kunderligjshem, por vetem me aktivitetete tregtare per te cilat kane qene te regjistruara ne organet tatimore.

Ne vendimin nr.13, date 11.05.2017 te dhene lidhur me çeshtjen penale me kerkuese -Prokuroria e Pergjithshme, me objekt -Vendosja e sekuestros preventive ndaj aksioneve ne pronesi te nje shtetaseje, e akuzuar dhe per vepren penaie te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka arsyetuar nder te tjera se :

*“Vepra penale e pastrimit te prodnkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale presupozon pastrimin e produkteve qe jane rrjedhoje e kryerjes se nje vepre penale. Ne rastin objekt shqyrtimi... ky Kolegj vlereson se indicjet e paraqitura nga ana e organit te akuzes, nuk arriten te kalojne pragun e dyshimeve te arsyeshme dhe ne keto kushte, ne mungese te nje vepre penale baze qe sherben per konfigurimin e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, nuk kemi te bejme me nje veper penale per te cilen mund te pretendohet venia e mases pasurore te sekuestros preventive. Lidhur me vepren penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, vepra penale baze nga e cila gjenerojne produktet perbehet vetem nga ato vepra qe prodhojne nje pasurim te dukshem e te prekshem dhe qe hyn ne disponibilitetin e subjektit. Kolegji veren se per te pasur vepren penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, veprimet kriminale e pershkruara nga norma penale kane per synim te perbashket pengimin e identifikimit te prejardhjes se sendeve te dyshuara si produkte te veprimtarise kriminale dhe ndalimin e futjes se tyre ne qarkullimin civil apo mbulimin e prejardhjes. Ne keto kushte, dyshimi per kryerjen e kesaj vepre penale dhe vendosja e sekuestros preventive nuk mund te mbeshtetet vetem ne posedimin e sendeve apo kryerjen e transaksioneve me vlere te larte, pasi kerkohet nje nivel me i larte indicjesh qe duhet te lidhe shumat e perdorura ne aktivite ne veprimtari sipermarrese me dyshimin per prejardhjen dhe veprimin e kunderligjshem, nga te cilat jane krijuar keto shuma”.*

Mbeshtetur ne konkludimet e sipercituara, si dhe referuar arsyetimit te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte ne vendimin nr.13, date 11.05.2017 gjykata konstaton se nuk plotesohen kriteret e anes objektive te figures se vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Sipas legjislacionit tone penal qe nje person te mbaje pergjegjesi penale duhet qe ne veprimet ose mosveprimet e tij te ekzistojne elementet e nje figure te caktuar vepre penale, te parashikuar nga ligji penal. Elementet e nje figure konkrete vepre penale eshte e domosdoshme qe te ekzistojne njekohesisht per te vene nje person perpara pergjegjesise penale dhe keta elemente jane: a) objekti i vepres penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Nese mungon njeri prej ketyre elementeve vepra penale nuk ekziston.

Ne situaten konkrete gjykata çmon se nuk ekziston vepra penale e “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, per te cilen eshte regjistruar procedimi penal, pasi mungon nje nga elementet e kesaj figure vepre penale qe eshte ana objektive.

**Si perfundim** gjykata konkludon se kerkesa e organit te Prokurorise eshte e drejte, pasi fakti per te cilin eshte regjistruar procedimi penal nga organi i akuzes nuk parashikohet nga ligji si veper penale dhe si rrjedhoje ne baze te neneve 328 pika 1, shkronja “b” dhe 329 /b pika 3 te K.Pr.Penale duhet te vendoset pushimi i çeshtjes penale nr.291, date 31.08.2017.

## PER KETOARSYE

## **VENDOSI**

1. Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec.
2. Pushimin e çeshtjes penale nr.291, date 31.08.2017 per vepren penale te “Pastrimit te produkt&ve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.
- 3.Shpenzimet procedurale siç jane bere.
- 4.Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçe brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se tij.

5. Ky vendim t'i komunikohet personit te kallezuar {xxx} .

U shpall ne Pogradec sot me date 09.09.2020, ora 10.09.

Shpenzime gjate fazes se hetimeve paraprake per kancelari, flete formati 2000 leke te paguara nga organi i

SEKRETARE MAATUELA  
BESHELLO



SI NZIMET )CEDURIALE

Prokurorise Shpenzime gjate gjykimit s'ka  
**Shuma totale e shpenzimeve 2000 leke te paguara nga  
organi i Prokurorise**

GJYQTARE  
LULJETA<sup>7</sup>  
KOLONJ.W'''



/2020

**Shenim:** Ky vendim ka marre forme te prere sot ne date

KANCELARI  
Guri SOFI



- Urdher per regjistrimin e procedimit penal date 31.08.2017.
- » Urdhrrat per kryerjen e veprimeve hetimore date 31.08.2017, date 02.03.2018.
- ® Informacioni per referimin e vepres penale tek prokurori date 21.08.2017.
- Shkresa nr.5793/5 prot, date 19.05.2017 e Drejtorise per Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar te Ministrise se Puneve te Brendshme.
- » Shkresa dergim informacioni nr.5793/1 prot, date 08.05.2017 e Drejtorise per Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar te Ministrise se Puneve te Brendshme.
- ® Shkresa nr. 1529/1 prot, date 26.04.2017 e organit te Prokurorise.

\*

- ® Shkresa dergim informacioni nr.796/2 prot, date 20.04.2017 e Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave te Ministrise se Financave. \*
- Shkresa dergim informacioni nr.5793/8 prot, date 12.06.2017, e Drejtorise per Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar te Ministrise se Puneve te Brendshme, bashkengjitur aktet.
- ® Shkresa kerkim informacioni nr. 1445 prot, date 09.06.2017 e Drejtorise Vendore te Policise Korçe.